



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **3 nëntor 2025, (e hënë)**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! I nderuar nënkryetar i komunës, **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë ju të pranishëm. E hapim mbledhjen e **dhjetë (10)** dhe të fundit për këtë vit.

Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë rend dite;

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i raportit financiar, janar – shtator 2025;**
- 3. Shqyrtimi i raportit vjetor i performancës komunale për vitin 2024.**

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, rendin e ditës e vendosim në votim. Kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht aprovohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A kemi diçka në lidhje me procesverbalin nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Unanimisht aprovohet pika e parë.

2. Shqyrtimi i raportit financiar, janar – shtator 2025:

Afrim Limani: I nderuar kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së. Kam kënaqësi që për herë të fundit, ndoshta edhe jo për të fundit, të prezantoj raportin financiar 9-mujor i Komunës së Rahovecit. Raporti është përbërë kryesisht prej tri pjesëve: Pjesa e të hyrave, pjesa e shpenzimit të buxhetit dhe pjesa e kontratave dhe shpenzimet komunalë. Totali i të hyrave për këtë periudhë është 1.623.823€ dhe kur e krahasojmë me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, atëherë kemi një diferencë pozitive prej 282.096€. Të Gjobat e trafikut dhe të gjykatave janë në shumën prej 118.000€ dhe ndoshta deri më tani është periudha më e mirë e inkasimit. Në raport nuk e kemi 3-mujorin e fundit, sepse është ndërruar sistemi dhe nuk kemi pasur mundësi dhe qasje t’i nxjerrim të dhënat. Shpenzimi i buxhetit në total për këtë periudhë është 20.080.000€ (84.62%). Shpenzimi në investime kapitale është 95.19%, subvencionet 84.84%, shpenzimet komunalë 82.87%, mallra dhe shërbime 88.85% dhe pagat 77.25%. Në këtë proces të shpenzimit të buxhetit është edhe Kontrata Kolektive dhe ju e dini që deri më tani nga thesari janë tërhequr 2.6 milionë €. Në raport, janë gjithashtu të paraqitura edhe kontratat e lidhura (14.489.000€). Këtu ka gjithashtu kontrata të lidhura, por që buxhetohen nga niveli qëndror.

Defrim Kafexhiu: I nderuar nënkryetar! E nderuar drejtoreshë e Shëndetësisë, e cila ka gjetur kohë të jetë e pranishme në KPF, të nderuar kolegë! Në lidhje me raportin nuk kam diçka, vetëm që drejtori e tha që mund të jetë edhe hera e fundit e prezantimit, por gjithashtu mund të jetë edhe hera e fundit e prezantimit prej teje si drejtor. Të përgëzoj për punën përgjatë këtij mandati. Le të fitojë më i miri.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor i performancës komunale për vitin 2024:

Blerta Nalli Gashi: I nderuar kryesues! Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa! Në mungesë të koordinatores për performancë, më lejoni që në cilësinë e anëtares së grupit punues, të paraqes një përmbledhje të shkurtër. Gjithsej i kemi 80.73 pikë, rezultat ky që e vendosë komunën tonë me performancë më të mirë në nivel vendi. Gjithsej janë 16 indikatorë dhe 76 nënindikatorë, të cilët me kujdes të shtuar janë analizuar nga anëtarët e grupit punues. Ju njoftoj që, në Grantin e Performancës do të jemi përfituesit e parë, sepse shumë komuna janë penalizuar për shkak të raportit të auditorit të përgjithshëm.

Kryesuesi: Faleminderit Blertë! A kemi diçka tjetër rreth kësaj pike?.. Nëse jo, atëherë këtu po e përfundojmë mbledhjen e dhjetë të KPF-së. Shihemi në mbledhjen e rregullt të kuvendit, më 5 nëntor 2025.

Procesmbajtësi

K R Y E S U E S I

Albion Krasniqi

Arbër Zenuni